



UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA

— FERIZAJ —

BËHU PROFESIONIST



[FACEBOOK.COM/USHAF.NET](https://www.facebook.com/USHAF.NET)



[INSTAGRAM.COM/USHA FERIZAJ](https://www.instagram.com/USHA FERIZAJ)



UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ

Rr. Universiteti, p.n. 70000 Ferizaj, Kosovë
Tel. +381 290 310 010 | www.ushaf.net

FAKUKTETI I INXHINIERISË DHE INFORMATIKËS

Në kuadër të këtij fakulteti ofrohet programi i studimeve Inxhinieri Industriale me Informatikë, në ciklin e parë, pra në bachelor, programi i studimeve në Informatikë të Aplikuar, në ciklin e parë, pra në bachelor, si dhe programi i studimeve në Inxhinieri dhe Informatikë, në ciklin e dytë, pra në master. Programet janë të organizuara në module dhe të vlerësuara me kredi, të cilat janë në përputhje me sistemin evropian të kredive. Këto programe u ofrojnë studentëve përvetësimin e shkathtësive adekuate për fushën e tyre të profesionit që do të ushtrorjnë në të ardhmen. Kjo mundësohet përmes ambienteve moderne të punës, pra laboratoreve dhe pajisjeve moderne, si dhe përmes bashkëpunimit me kompani e institucione kombëtare e ndërkombëtare.

Mendime të studentëve rreth përzgjedhjes së programit të studimeve në UShAF



Donikë Guri, studente e vitit të tretë në programin Inxhinieri Industriale me Informatikë:

"Perspektiva e madhe për vende të punës në rajonin e Ferizajt, si dhe pozita gjeografike e Universitetit kanë bërë të jenë zgjedhje ideale për mua. Mundësitë e studimit semestral jashtë vendit, vizitat e shumta në kompani të ndryshme, pastaj puna praktike në to, po edhe në laboratorët e Universitetit, ofrojnë mundësi jashtëzakonisht të mëdha në avancimin tonë. Falë shumëllojshmërisë së lëndëve në këtë fakultet, ne tashmë jemi të aftë në fushën e inxhinierisë si dhe në fusha të tjera si: informatika, fizika e matematika."

Skeno QR CODE
për të parë video materiale



BAÇELOR

Programi Inxhinieri Industriale me Informatikë fokusohet në zhvillimin e kuadrove të reja në fushën e inxhinierisë industriale, dhe aplikimin e teknologjisë informative në proceset e përpunimit të metaleve dhe materialeve të ndryshme plastike, duke përdorur teknologjinë dhe aplikacionet më moderne të teknologjisë informative, të cilat u përshtaten kërkesave të tregut të punës.

- të shprehin rrjedhshëm idetë komplekse dhe të sofistikuara, duke përdorur një gamë të formateve dhe mediave; dhe
- të kryejnë aktivitete me aftësi të mira shoqërore dhe udhëheqëse, dhe të demonstrojnë një ndjenjë të përgjegjësisë.

MUNDËSI PUNËSIMI NË TË ARDHMEN

Pas përfundimit të studimeve, një i diplomuar do të mund të punonte si:

- përpunues i produkteve nga metali dhe atyre nga plastika,
- dizajner kompjuterik i pjesëve të ndryshme makinerike,
- mësimdhënës në institucione fillore dhe të mesme teknike,
- mbikëqyrës i prodhimit,
- zhvillues dhe dizajner i procesit, ose
- i vetëpunësuar dhe sipërmarrës.

QËLLIMI

Duke ditur se tregu i punës ka mungesë të profesionistëve në fushën e inxhinierisë industriale dhe aplikimit të teknologjisë informative në proceset e përpunimit të produkteve, Universiteti, përmes këtij programi, ka për qëllim të krijojë kuadro të kualifikuara vendase, të cilat në të ardhmen do të ndihmojnë në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Që studentët në të ardhmen të kenë sukses në një mjedis konkurrues dhe që ndryshon vazhdimisht, Universiteti ofron mësim teorik dhe praktik, i cili u ndihmon:

- të kuptojnë konceptet themelore të inxhinierisë industriale;
- të njohin llojet e metaleve dhe materialeve artificiale, si dhe teknologjitë e përpunimit të tyre;
- të zhvillojnë aftësitë praktike për përpunimin e materialeve të ndryshme, në veçanti të atyre artificiale;
- të aplikojnë njohuri të koncepteve, teorive dhe disiplinave në inxhinieri industriale, të përkrahura nga teknologjia informative;
- të demonstrojnë aftësitë e të menduarit kritik në zgjidhjen e problemeve komplekse në fushën e inxhinierisë industriale;

Viti I

Semestri I			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Matematika I	5
2	O	Kimi Fizikë	5
3	O	Materialet Inxhinierike I	5
4	O	Shkathësi Informatike	5
5	O	Grafika Inxhinierike	5
6	O	Softuerët Aplikativ	5

Semestri II			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Matematika II	6
2	O	Mekanika I	6
3	O	Materialet Inxhinierike II	6
4	O	Menaxhimi i Ndërmarrjeve	6
5	O	Gjuhë Angleze I	3
6	O	Gjuhë Gjermane I	3

Viti II

Semestri III			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Programimi	5
2	O	CAD I	5
3	O	Mekanika II	6
4	O	Ndërmarrësi dhe Inovacion	4
5	O	Proceset e Prodhimit	4
6	O	Gjuhë Angleze II	3
7	O	Gjuhë Gjermane II	3

Semestri IV			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Bazat e Elektroteknikës me Elektronikë	5
2	O	CAD II	5
3	O	Detalet e Makinave	6
4	O	Përpunimi i Materialeve I	4
5	O	Menaxhimi i Kostos	4
6	Z	Gjuhë Angleze III	3
7	Z	Gjuhë Gjermane III	3

Viti III

Semestri V			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Përpunimi i Materialeve II	4
2	O	Menaxhimi i Projekteve Inxhinierike	4
3	O	Metodat Jokonvencionale të Përpunimit	5
4	Z	Saldimi	5
5	Z	Energjia në Dizajnin Inxhinierik	4
6	Z	Projektimi i Proceseve Teknologjike	4
7	Z	Mekatronika	4
8	Z	Matja dhe Kontrolli	4

Semestri VI			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Dizajnimi dhe Zhvillimi i produkteve	4
2	O	Praktikë (Internship)	4
3	O	Rregullimi Automatik/Kontrolli	5
4	Z	Inxhinieria Kthyesë dhe Modelimi 3D	5
5	Z	Riciklimi i Materialeve	4
6	Z	Sistemet Hidraulike dhe Pneumatike	4
7	Z	Ngrohja dhe Ventilimi i Objekteve	4
8	Z	Saldimi	4

O - Lëndët Obligative

Z - Lëndët Zgjedhore

ECTS - (European Credit Transfer System) | (Sistemi Evropian i Transferimit të Kredisë)

BAÇELOR

Gjatë takimeve të shumta me komunitetin e biznesit, shpesh është diskutuar kërkesa e të kualifikuarve në fushën e informatikës së aplikuar. Prandaj, mund të themi se programi Informatikë e Aplikuar, si një fushë relativisht e re e studimit në Kosovë, u dedikohet të rinjve që duan të jenë më praktik dhe që kontribuojnë në zhvillimin e këtij sektori. Programi mbulon një gamë të gjërë temash që ofrojnë një kombinim të specializuar të njohurive në shkencat kompjuterike, në programim, në administrim të rrjeteve kompjuterike, në biznes dhe menaxhim. Studentët fitojnë një pasqyrë të detajuar të teknologjive më të fundit të informacionit dhe komunikimit.

QËLLIMI

Programi ka për qëllim të ofrojë lëndë me përmbajtje moderne dhe fleksibile, si dhe vendosje praktike në industri, të cilat do të ndjekin me lehtësi kërkesat e ekonomisë vendore dhe ndërkombëtare, si dhe të tregut të punës në nivel lokal, rajonal dhe global.

OBJEKTIVAT E PËRGGJITHSHME

Që studentët të kenë sukses në të ardhmen, në një mjedis konkurrues dhe që ndryshon vazhdimisht, Universiteti u ofron mësim teorik dhe praktik, i cili u ndihmon:

- të analizojnë kërkesat e teknologjisë së informimit, duke marrë parasysh nevojat e konsumatorëve dhe t'i zbatojnë këto kërkesa në një mënyrë praktike;
- të analizojnë, modelojnë, abstrahojnë dhe zbatojnë aspekte afariste dhe teknike në rrjedhën e projekteve të teknologjisë së informimit;
- të njihen me tema të specializuara për të kuptuar ndërlidhjet teknike komplekse në mjedisin e biznesit;
- të zbulojnë metoda për të mbështetur strategjinë e kompanisë dhe nevojat për përpunimin

e informacionit, në mënyrë që të optimizohen proceset komplekse përmes përdorimit të teknologjisë më të fundit të informacionit;

- të analizojnë dhe projektojnë sisteme, si dhe skenarët e tyre të ndërveprimit;
- të shikojnë problemet si nga perspektiva e konsumatorit, ashtu edhe nga ajo një kontraktori;
- të identifikojnë, diskutojnë dhe zgjidhin konfliktet potenciale dhe keqkuptimet e mundshme midis biznesit dhe teknologjisë në nivel teknik dhe ndërpersonal, si dhe marrjen e masave parandaluese;
- të komunikojnë me profesionistët teknikë dhe jo teknikë, të paraqesin informacion teknik, ashtu që të jetë i kuptueshëm për personelin jo-teknik dhe të kontribuojnë në mënyrë konstruktive për të siguruar bashkëpunim pozitiv brenda ekipeve;
- të zbatojnë qasjen ndërdisiplinore në hartimin e sistemeve të teknologjisë së informimit; dhe
- të identifikojnë ndërlidhjet në mënyrë holistike.

MUNDËSI PUNËSIMI NË TË ARDHMEN

Pas përfundimit të studimeve, një i diplomuar do të mund të punonte si:

- programer (Desktop, Ueb dhe telefona mobil),
- specialist i teknologjisë së informimit në kompani të ndryshme,
- konsulent i sistemit,
- projektues i sistemit,
- analist i biznesit,
- arkitekt i teknologjisë së informimit,
- koordinator i teknologjisë së informimit,
- arkitekt i sistemit,
- specialist i informatikës së biznesit,
- administrator i shërbimit të teknologjisë së informimit,
- administrator i rrjetit kompjuterik,
- menaxher i projektit ose asistent i menaxherëve të projektit,
- koordinator i projektit, ose

PLANPROGRAMI ME LËNDËT OBLIGATIVE DHE LËNDËT ZGJEDHORE

Viti I

Semestri I			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Matematikë	5
2	O	Bazat e Informatikës	5
3	O	Programim	5
4	O	Shkathësi Komunikuese	5
5	O	Teknologjitë e Rrjetave Kompjuterike	5
6	O	Menaxhment dhe Ndërmarrësi (për IT)	5

Semestri II			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Struktura Diskrete	4
2	O	Arkitektura e Kompjuterëve	5
3	O	Programimi i Orientuar në Objekte	5
4	O	Hyrje në Ueb Teknologjitë	5
5	O	Baza e të Dhënave	5
6	O	Gjuhë Angleze 1	3
7	O	Gjuhë Gjermane 1	3

Viti II

Semestri III			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Algoritme dhe Struktura e të dhënave	5
2	O	Modelet Statistike	5
3	O	Programimi në Ueb	5
4	O	Sistemet Operative	5
5	O	Gjuhë Angleze 2	3
6	O	Gjuhë Gjermane 2	3
7	O	E Drejta dhe Etika e Biznesit	4

Semestri IV			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Kërkime Operacionale	5
2	O	Aplikimi i TI-së në Ndërmarrje	5
3	O	Rrugëtimi i Rrjetave Kompjuterike	5
4	O	Siguria në TI	5
5	O	Gjuhë Angleze 3	3
6	O	Gjuhë Gjermane 3	3
7	O	Analiza e Kostos dhe Financave	4

Viti III

Semestri V			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Inxhinieria Softuerike	5
2	O	Menaxhimi i Projekteve në TI	5
3	O	Zhvillimi i Aplikacioneve Mobile	5
4	O	Organizimi dhe Menaxhimi i Personelit	5
5	O	Marketingu dhe Shitjet	5
6	Z	Siguria e Rrjetave Kompjuterike	5
7	Z	Testimi i Softuerit	5

Semestri VI			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Praktikë	5
2	O	Cloud Computing	5
3	O	Projekt	5
4	O	Aplikacionet e Internetit të Gjërave	5
5	O	Intelegjenca Artificiale	5
6	Z	Rrjetat Kompjuterike Konektuese	5
7	Z	Zhvillimi hibrid i Aplikacioneve mobile	5

O - Lëndët Obligative, Z - Lëndët Zgjedhore, ECTS - (European Credit Transfer System) | (Sistemi Evropian i Transferimit të Kredisë)

MASTER

• i vetëpunësuar, pra si i pavarur.
Programi Inxhinieri dhe Informatikë, në nivelin master, u hartua bazuar në kërkesat e tregut të punës, si dhe përmes një bashkëpunimi të ngushtë me komunitetin e biznesit. Prandaj, mund të themi se programi përmbush mangësi të shumta të tregut të punës në Kosovë, duke kualifikuar studentë me njohuri dhe shkathtësi në dizajn të produktit, të cilët do të mund të përdorin teknologjinë moderne, por të cilët do të jenë gjithashtu të vetëdijshëm për proceset industriale.

QËLLIMI

Qëllimi i programit është të zhvillojë kuadro të specializuara të profesionistëve në fushën e inxhinierisë, me fokus në zhvillimin dhe dizajnimin e produkteve, duke përdorur teknologjinë dhe aplikacionet më moderne të teknologjisë informative, të cilat u përshtaten lehtë kërkesave të tregut të punës.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Që studentët të kenë sukses në të ardhmen, në një mjedis konkurrues dhe që ndryshon vazhdimisht, Universiteti u ofron mësim teorik dhe praktik, i cili u ndihmon:

- të punojnë në mënyrë individuale dhe grupore në problemet teorike dhe praktike (duke gjetur dhe aplikuar metodat adekuate të hulumtimit shkencor);
- të kuptojnë kompleksitetin e procesit të operacioneve të prodhimit dhe ndikimit të tij në dizajnin e produktit apo procesit, dhe anasjelltas;
- të aplikojnë metodat moderne të menaxhimit të cilësisë në funksion të rritjes së efikasitetit;

- të shfrytëzojnë programet moderne kompjuterike (CAD, SolidWORKS, CREO, FUSION, etj) në dizajnimin dhe analizimin/simulimin e funksionimit të produktit apo procesit të dizajnuar;
- të planifikojnë, iniciojnë dhe ekzekutojnë projekte të ndryshme inxhinierike;
- të menaxhojnë produkte dhe grupe (familje) të produkteve, që nga ideja, dizajni e deri te zhvillimi i tij gjatë gjithë ciklit të tij jetësor; dhe
- të menaxhojnë mbrojtjen dhe sigurinë në punë si dhe ruajtjen e ambientit.

MUNDËSI PUNËSIMI NË TË ARDHMEN

Pas përfundimit të studimeve, i diplomuari do të mund të punonte si:

- inxhinier i projektimit,
- zhvillues/ menaxher produkti,
- mbikëqyrës i prodhimit,
- zhvillues dhe dizajner i procesit,
- menaxher i përgjithshëm në një kompani prodhimi,
- i vetëpunësuar dhe sipërmarrës, ose
- menaxher i projekteve.

Viti I			
Semestri I			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	Metoda Kërkimore	6
2	O	Teoria dhe Praktika e Menaxhimit	6
3	O	Materialet Moderne Inxhinierike	6
4	O	Menaxhimi i Financave dhe Kostos	6
5	O	Inxhinieria Kthyse dhe Printimi i Shpejt	6
Semestri II			
1	O	Menaxhimi i Projekteve dhe Investimeve	6
2	O	Analiza e Elementeve të Fundme	6
3	O	Modelimi në 3D dhe Vizualizimi	6
4	O	Menaxhimi i Zinxhirit Furnizues	6
5	Z	Marketingu dhe Shitja	6
6	Z	Menaxhimi i Inovacioneve	6
7	Z	Polimerët, Përpunimi dhe Procesimi i tyre	6
Viti II			
Semestri III			
Nr.	O/Z	Lëndët	ECTS
1	O	CAD/CAM	6
2	O	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Produkteve	6
3	O	Proceset e Prodhimit	6
4	Z	Ndërmarrësia	6
5	Z	Automatizimi dhe Prodhimi Kompjuterik i Integruar (PKI)	6
6	Z	Menaxhimi i Mjedisit dhe Ruajtja e Ambientit	6
7	Z	Menaxhimi dhe Standardet e Cilësisë	6
Semestri IV			
1	O	Tema e masterit	30

O - Lëndët Obligative

Z - Lëndët Zgjedhore

ECTS - (European Credit Transfer System) | (Sistemi Evropian i Transferimit të Kredisë)

Për tu informuar rreth mundësive për të studiuar në UShAF, bëhuni pjesë e aktivitetit “Open Doors” me datën 17, 18, 19 Maj dhe shihni mundësitë që ofron Universiteti ynë.

Me ne, jeni më afër tregut të punës!

Ofrojmë siguri në ecjen tuaj përkrah studentëve të vendeve të zhvilluara!

Bashkë mund ta zhvillojmë Kosovën!



FACEBOOK.COM/USHAF.NET



INSTAGRAM.COM/USHAFERIZAJ



UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ

**Rr. Universiteti, p.n. 7000 Ferizaj, Kosovë
Tel.+381 290 310 010 | www.ushaf.net**